



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA E FINANCES BUXHETIT DHE KONTABILITETIT

Nr. 9608 prot.

Vlorë, më 20.06 2024

PROJEKT-VENDIM
Nr. ____, Datë ____.2024

**“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR.100, DT.29.12.2023
PËR BUXHETIN E BASHKISË PËR VITIN 2024” i ndryshuar.**

Në bazë të Ligjin nr,139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 8, pika 2, 9 pika 1.1 b, 34, 35, 36, 37,40, 41, 54 pika dh, dhe neni 64 pika c , Ligji nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 45, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 44 ; Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarte të Menaxhimit të Buxhetit”, Udhëzimi plotësues nr.2 datë 28.02.2024 “Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2024”, V.K.B nr.100 datë 29.12.2023 “Për Miratimin e Buxhetit të Bashkisë për Vitin 2024”.VKB nr 29 datë 28.03.2024 i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 15, datë 26.02.2024 Për krijimin e shoqërisë Markata e Peshkut Vlorë, si dhe relacioni i paraqitur nga administrata e Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Vlorë në mbledhjen e datës 27.06.2024.

VENDOSI:

1. Të miratohet programi buxhetor 04230 “ Mbeshtetje per Peshkimin”.
2. Të miratojë vlerën financiare për venien në efencë të SHA Markata e Peshkut, me vlerë 4,922,249 lekë,
3. Në shpenzimet e Bashkisë me kod program 1110, të pakësohet fondi prej 4,922,249 lekë, në llogarinë ekonomike 602 (Administrata) në objektin ”Shpenzime te tjera dhe të shtohet në llogarinë ekonomike 603 suvensione me kod programi 04230 në objektin e shoqërisë “Markata e Peshkut Vlorë”.

a) Pakësohen te Shpenzimet Operative (te tjera) ne Programet (1110)

G	Titull	Kap	600	601	602	Shpenzimet Operative (te tjera)
00	1110	5			4,922,249	

a) Pakësohen te Shpenzimet Operative (te tjera) ne Programet (04230)

G	Titull	Kap	600	601	603	Mbeshtetje për Peshkimin Shoqëria “Markata e Peshkut Vlorë”.
00	04230	5			4,922,249	

3.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë .

4.Ky Vendim hyn në fuqi bazuar në VKM nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55, pika 6.

KRYETAR

Ermal Dredha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E FINANCËS BUXHETIT DHE KONTABILITETIT

Nr. 9669 prot.

Vlorë, më 2008 2024

RELACION

MBI PROJEKT-VENDIMIN “PËR NJË RISHPËRNDARJE TË FONDIT TË SHPENZIMEVE OPERATIVE TE BASHKISË TË PARASHIKUAR NË VKB NR.100, DT.29.12.2023, PËR BUXHETIN E BASHKISË PËR VITIN 2024 I NDRYSHUAR ”

Të nderuar Këshilltarë,

Projekt-vendimi që po ju paraqesim për miratim lidhet me realizimin për venien në eficencë të SHA Markata e Peshkut,

Duke marrë parasysh planin e biznesit të subjektit Merkata e Peshkut ,fillimisht kërkohet mbështetja financiare për nevojat bazë për fillimin e aktivitetit ,si paga dhe shpenzime operative (energji,uje) etj.

Në shpenzimet e Bashkisë me kod program 1110, do të pakësohet fondi prej 4,922,249 lekë, në llogarinë ekonomike 602 në objektin ”Shpenzime te tjera dhe të shtohet në llogarinë ekonomike 603 suvensione me kod programi 04230 në objektin e shoqërisë “Markata e Peshkut Vlorë”.

KRYETAR

Ermal Dredha

